



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite - Ministry of Labour and Social Welfare

Informatori: **I-1**
Informator:

FLETA INFORMUESE PËR SKEMËN E NDIHMËS SOCIALE

Para se të paraqitni kërkesën, ju duhet të dini se ndihmat sociale ipen për familje në bazë të Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, dhe Ligjit Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë.

Sipas këtij Ligji FAMILJA përkufizohet si: një grup individësh që jetojnë bashkë nën një kulm dhe që bashkarisht ndajnë shpenzimet e jetesës dhe përbëhet prej paraqitësit të kërkesës, bashkëshortit/es ose partnerit/es, prindërve dhe fëmijëve (përfshirë fëmijët e birësuar/bijësuar, në strehim familjarë apo të njërit partner).

Per te perfituar ndihme sociale familja juaj nuk duhet të ketë më shumë se 0.5 ha tokë, nuk duhet të ketë të ardhura dhe duhet të plotësojë kriteret për njërin prej dy kategorive.

Në kategorinë e I-rë përfshihen familjet që kanë:

- Personat mbi 18 vjeç me aftësi përherë të kufizuara dhe të paafitë për punë
- Personat mbi 65 vjeç
- Kujdestarët e përhershëm të personave me aftësi të kufizuara dhe mbi 65 vjeç
- Personat deri në moshën 14 vjeç
- Personat ndërmjet 15 dhe 18 vjeç që janë në shkollim të rregullt
- Prindërit vetëushqyes me së paku një(1) fëmijë nën moshën 15 vjeç

Në kategorinë e II-të përfshihen:

- Familjet me një anëtarë të aftë për punë dhe
- Me të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeç
- Që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën 15 vjeç.

Nëse mendoni se familja juaj i plotëson kriteret e mesiperme, ju mund të paraqitni kërkesë në Qendrën për Punë Sociale në Komunën në të cilën jetoni.

Kërkesës suaj për Ndhmë Sociale duhet t'ia bashkangjiti këto dokumente:

- Letërnjoftimin – për të gjithë anëtarët e familjes mbi moshën 16 vjeçare
- Certifikatat e lindjes-për të gjithë anëtarët e familjes
- Certifikatat e vdekjes- për të dy prindërit e anëtarit jetim të familjes ose partnerit të prindit vetëushqyes (nese ata jane te vdekur);
- Deklaratat e papunësisë-(a) për paraqitësin e kërkesës dhe anëtarët e familjes të moshave prej 18 deri në 65 vjeç të aftë për punë , dhe /ose, (b)për anëtarët e familjes të moshave prej 15 deri në 18 vjeç që nuk vijnë rregullisht shkollën e mesme;
- Certifikata e kurorëzimit
- Certifikata e shkurorëzimit- e prindit vetëushqyes në rast të shpëputjes së martesës;
- Deklarata e bashkësisë familjare;
- Vendimi gjykatës mbi trashëgiminë;
- Kontrata mbi shpëputjen e bashkësisë familjare e vërtetuar nga gjykata;
- Certifikata e mjekut për aftësinë e kufizuar- të paraqitësit të kërkesës dhe/ose anëtarëve të familjes- nëse paraqitësi i kërkesës dhe/ose anëtar i familjes paraqesin kërkesën në baza të aftësisë përherë të kufizuar;
- Vendimet e pensioneve të personave me aftësi të kufizuar (PPAK) nga MPMS-ja për anëtarët e familjes duhet të jenë me afat të vlefshëm;
- Vlerësimi i komisionit mjekësor duhet të ketë afat jo më pak se 1 vit dhe certifikata të posedojë numër serik;
- Certifikata e Kadastrës për tokën- e paraqitësit të kërkesës dhe anëtarëve të familjes që janë 18 vjeç apo më tepër; këtu duhet të përfshihen gjithashtu detajet e prindërve të vdekur dhe/ose kujdestarëve;
- Certifikata nga organi përkatës komunal për lartësinë e tatimit mbi pronën- e paraqitësit të kërkesës dhe anëtarëve të familjes që janë 18 vjeç apo më të vjetër; këtu duhet të përfshihen gjithashtu detajet e prindërve të vdekur dhe/ose kujdestarëve;
- Vendimet që kanë të bëjnë me raportet familjare nga Shërbimet Sociale, Organeve të Administratës Komunale, organizatave jo qeveritare dhe gjykatave duhet të jenë me afat të vlefshëm
- Faturën për harxhimin e rrymës në vendbanimin ku jeton
- Vërtetim nga Qendra për Punë Sociale e vendbanimit të përhershëm fillestarë- për personat e zhvendosur brenda për brenda në të cilin thuhet se nuk marrin NS në atë komunë prej nga janë zhvendosur;
- Certifikata e kurorëzimit – për personat e martuar në familje, posaçërisht për bashkëshortin(bashkëshorten) e paraqitësit të kërkesës , nëse ai person është i përfshirë në kërkesën e paraqitur;
- Certifikata e shkollës- për paraqitësin e kërkesës dhe anëtarët e familjes të moshave prej 15 deri në 18 dhe vijnë shkollimin e rregullt;
- Vërtetimet e shkollës për fëmijët prej moshës 6 deri 14 vjeç (e dëshirueshme)
- Leja e qarkullimit dhe sigurimit për automjetin motorik- që shfrytëzohet nga familja vetëm për nevoja shtëpiake.

Nëse ekziston arsyeja do të kërkohen edhe dokumente të tjera.

Mos harroni: Se ju mund të paraqitni kërkesë vetëm nëse të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë shtetas të Republikës të Kosovës dhe të plotësojnë kushtet për, kategorizim në njërin prej prej kategorive të percaktuara me këtë Ligj. Përfshirë shfrytëzues të ndihmës sociale, mund të jenë edhe shtetasit e huaj, të cilët kanë leje qëndrimi në Kosovë, që janë azilkërkues, refugjatë, dhe persona të cilët kanë mbrojtje të perkohshme dhe plotësues.

Duhet të keni parasysh: Qendra për Punë Sociale do të bëjë vizitë në shtëpinë TUAJ.

Në rast të paraqitjes së të dhënave jo të vërteta JU do të sanksionoheni sipas Ligjit.